



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2020:116002  
Datë: 26.09.2024  
Numri i dokumentit: 06213535

K.Dh.Sh.II.nr.1073/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Ramush Bardiqi kryetar, Dren Rogova dhe Krenar Berisha, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “DM” ShPK me seli në Mitrovicë i përfaqësuar nga avokatura SCLR Partneres me seli ne Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës së Jugut, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.328/22 të datës 18.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa e paditësit “DM” ShPK me seli në Mitrovicë.
- II. **PRISHET** Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.328/22 i datës 18.02.2024, , dhe çështja i kthehet në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.146/22 të datës 16.10.2023, është refuzuar në tërësi kërkesëpadia e paditësit “DM” ShPK me seli në Mitrovicë, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës së Jugut, për shkak të anulimit të vendimt nr.01463/01-0046928-2/20 të datës 17.08.2020, i të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore – Kryetarit të Komunës, si të paligjshëm dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura, si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të ligjit material, me propozimin që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit, të anulohet në tërësi si i kundërligjshëm aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhomave të Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Administrative me numër KA.nr.328/22 të datës 18.02.2024 dhe lënda i kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje Gjykatës Komerciale – Dhomave të Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Administrative.

Tutje ka theksuar se vendimi kontestues është i kundërligjshëm pasi i njëjti organ administrative ,pra kryetari i komunës, ka vepruar se organ i shkalles se pare dhe organ i shkalles se dyte ne kundërshtim me ligjin ne fuqi

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në procedurën administrative të ankesave, e Komuna e Mitrovicës së Jugut, me vendimin nr.01463/01-0046928-2/20 të datës 17.08.2020, të nxjerr nga Kryetari i Komunës, ka refuzuar si të pabazë ankesën nr.01-463/01-0046928/20 të datës 12.08.2020 të parashtruar nga Shoqëria “DM” ShPK me seli në Mitrovicë, kundër vendimit të Kryetarit të Komunës, për Lirimin e pronës së paluajtshme Komunale në vendin e quajtuar “tregu Multietnik” nr.01-463/01-0046166/20 të datës 11.08.2020.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Komuna e Mitrovicës së Jugut , ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 18.09.2020, me pretendim se vendimi i të paditurës është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhomat e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditësve paraqitur kundër vendimit të paditurës Komuna e Mitrovicës së Jugut, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor datës 18.02.2024, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin padinë e paditësit e refuzon si të pabazuar me arsyetimin se Gjykata gjen se, organi i paditur ka vlerësuar drejtë gjendjen faktike, me rastin e nxjerrjes së vendimit për shkëputjen e kontratës pasi që, paditësi me rastin e lidhjes së kontratës Nr. 050/2009 të datës 07.10.2009 për Dhënie në Shfrytëzim të Paluajtshmërisë nga Pronësia Komunale, ka qenë në dijeni se të drejtën e shfrytëzimit e ka pasur për një periudhë 10 (dhjetë) vjeçare, andaj me përfundimin e afatit kontraktual sipas kësaj kontrate paditësi ka qenë në dijeni se përfundon e drejta shfrytëzimit të pronës, në përputhje me nenin 23 paragrafi 1 të Ligjit 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe këmbim të Pronës së Paluajtshme, i cili parasheh se “ Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës”. 25. Gjykata vlerëson se aneks kontrata me datë 07/10/2019 e lidhur ndërmjet “DM” SH.P.K., dhe Komunës së Mitrovicës, e nënshkruar nga Zyrtari i Prokurimit për vazhdim të vlefshmërisë/kohëzgjatjes të kontratës bazë prej datës 07.10.2019 deri më datë 07.10.2029, është e kundërligjshme sepse me asnjë dispozite ligjore zyrtari i prokurimit nuk është i autorizuar të nënshkruaj kontratë për dhënie e pronës se paluajtshme të komunës tek palët e treta dhe as vazhdim te afatit. Në këtë rast veprimi i zyrtarit të prokurimit është në kundërshtim me Neni 14 të Ligji 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, ku përcaktohet procedura e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale: Propozimi për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme

të komunës 1. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës për miratim paraprak pronën e paluajtshme të komunës për dhënien në shfrytëzim, duke paraqitur arsyet dhe interesin publik. 2. Propozimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës duhet të identifikojë të dhënat kadastrale të pronës, madhësinë e saj, të specifikojë arsyet, qëllimin, kohëzgjatjen si dhe formën në të cilën rekomandohet procesi për dhënien e pronës në shfrytëzim. 3. Kuvendi i Komunës merr vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës me shumicën e votave të anëtarëve që janë prezent në seancë të Kuvendit të Komunës. Prandaj gjykata ri-kujton se dhënia në shfrytëzim të pronës komunale është përfundimisht në kompetencë të Kuvendit të Komunës e jo Zyrtarit të Prokurimit.

Dhomat e Shkallës së Dytë, duke shqyrtuar në thellësi aktgjykimin e ankimuar dhe duke u mbështetur në shqyrtimin e dokumenteve të lëndës si dhe në pretendimet ankimore, kanë arritur në përfundimin se aktgjykimi në fjalë është prekur nga shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas nenit 182 paragrafi 2 pika n) dhe nenit 183 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), i zbatueshëm gjithashtu sipas nenit 63 të Ligjit për Kontestet Administrative (LKA). Ky aktgjykim është konstatuar si juridikisht i paqartë dhe i kundërt me vetveten, si dhe i paplotë në lidhje me vërtetimin e gjendjes faktike.

Kolegji vlerësoi se aktgjykimi i ankimuar është i mangët në përmbledhjen e fakteve vendimtare, duke dështuar të sqarojë nëse akti administrativ i kontestuar është nxjerrë duke respektuar dyshkallshmërinë e shqyrtimit nga organi administrativ. Kolegji i kësaj gjykate vëren se organi administrativ, në këtë rast Kryetari i Komunës, ka shqyrtuar dhe nxjerrë vendim në shkallën e parë dhe, për të njëjtën çështje, ka vepruar gjithashtu në shkallën e dytë, duke krijuar kështu një shkelje të dyshkallshmërisë së procesit administrativ.

Sipas nenit 131 paragrafi 1 dhe 5 të Ligjit për Procedurën Administrative (LPPA), ankesa kundër një akti administrativ duhet të shqyrtohet fillimisht nga organi kompetent publik. Në rast se organi kompetent e konsideron ankesën si të papranueshme ose të pabazuar, duhet ta përcjellë atë te organi epror, së bashku me të gjitha dokumentet përkatëse dhe një raport të qëndrimit të saj. Ndërsa, sipas nenit 132 paragrafi 1 dhe 2 të LPPA-së, organi epror duhet të shqyrtojë ankesën dhe, nëse është e nevojshme, të zhvillojë shqyrtime shtesë dhe të informojë për to. Nëse ankesa është e papranueshme ose e pabazuar, organi epror do të refuzojë ankesën me akt administrativ.

Kolegji i kësaj gjykate ka konstatuar se Komuna e Mitrovicës Jugore nuk ka respektuar dispozitat ligjore të lartpërmendura në procesin e nxjerrjes së aktit administrativ. Kolegji ka shqyrtuar pretendimet ankimore të paditësit se vendimi kontestues është i kundërligjshëm pasi i njëjti organ administrative, pra kryetari i komunës, ka vepruar si organ i shkallës së parë dhe organ i shkallës së dytë në kundërshtim me ligjin në fuqi, dhe ka gjetur se, në bazë të vendimit kontestues vërtetohet fakti me dispozitivin e vendimit kontestues theksohet se „*Refuzohet ankesa e ankuesit dhe vërtetohet vendimi i kryetarit të komunës nr. 01-463/01-0046166/20, e datës 11.08.2020*„. Kjo ka shkakuar një shkelje të parimit të dyshkallshmërisë, duke vepruar në mënyrë të kundërligjshme dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 131 dhe 132 të Ligjit për Procedurën

Administrative (LPPA). Kolegji i Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar, e në raport me pretendimet ankimore ka gjetur se ky pretendim i paditësit është ngrit edhe në gjykatën e shkallës së parë, mirëpo gjykata e shkallës së parë nuk shqyrtuar këtë pretendim të paditësit, Andaj kolegji vlerëson se Gjykata e shkallës së parë nuk ka trajtuar me kujdes të gjitha pretendimet e paditësit mbi këtë çështjen në procedurë. Kështu gjykata e shkallës së parë në aktvendimin e saj shprehet se ka vlerësuar se pretendimet e paditësit e të cilat sipas saj janë të pabazuara në ligj, por e njëjta gjykatë nuk ka trajtuar pretendimin e paditësit sa i përket vendimmarrjes së kryetarit të komunës-paditurës si organ administrativ.

Aktgjykimi i goditur është i mangët dhe nuk përmban të gjitha elementet dhe pikat e vlerësimit për secilën pretendim të propozuesit, për një vendim të arsyetuar, sepse nuk i janë adresuar argumentet thelbësore, me rastin e vlerësimit, për arsye se gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar fare pretendimin e paditësit sa i përket vendimmarrjes në vendimin kontestues së Kryetarit Komunës-paditurës, me ç ‘rast ka bere shkelje te dispozitave ligjit te procedurës kontestimore në baze të nenit 183 të LPK-se pasi nuk a vërtetuar në mënyre të plot gjendjen faktike. Kolegji vlerëson se një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për t'u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga gjykata e shkallës së dytë. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të këtë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë. Funkcioni tjetër i një vendimi të arsyetuar është t'u dëshmojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe t'u ofrojë mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Kjo gjendje faktike, konsiderohet e pavërtetuar në tërësi, marr parasysh këtu pretendimet e të paditurit të cekura në ankesë. Rrjedhimisht, Gjykata në rrethanat e rastit konkret, duke marrë parasysh që Gjykata e shkallës së parë, ka dështuar të adresojë dhe arsyetojë pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës të ngritura para saj, andaj, aktgjykimi i atakuar nuk është në përputhje me standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor, siç janë të përcaktuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-se dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-se.

Në lidhje me pretendimet ankimore të palës së paditësit, kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes në arsyetim të aktgjykimit është dashur ti jep të gjitha vlerësimet e saj, në lidhje me të gjitha çështjet e ngritura nga palët ndërgjyqëse. Gjykata e shkallës së parë ka pasur për obligim që në arsyetim të aktvendimit të trajtojë të gjitha kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat në drejtim të vërtetimit të plot dhe të drejte të gjendjes faktike. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë ka dështuar të jep sqarime të nevojshme në arsyetim të aktgjykimit në lidhje me pretendimet e paditësit.

Gjykata e shkallës së parë, në ri procedurë, në seancë gjyqësore, duhet të bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit kontestues, vendim i marrë nga e paditura, e që është objekt shqyrtimi në këtë çështje juridike, të përcaktojë saktë nëse organi publik që e ka nxjerr këtë vendim ka pasur kompetencë për nxjerrjen e tij, ashtu siç parashihet me dispozitat e ligjit për procedurën e përgjithshme administrative. Te kërkojë nga e paditura vendimin e shkallës së parë

nr. 01-463/01-0046166/20, e datës 11.08.2020 për lirim prone dhe te konstatoj se nga cili organ është vendos ky vendim, dhe shqyrtoj kompetencat e vendimmarrjes te organit administrativ-paditurës, dhe varësisht nga konstatimi i këtyre fakteve te marre vendim te drejtë edhe te bazuar ne ligj. Pasi qe ne kuptim te nenit 44 parag 2 te LKA-së përcaktohet se për nulitetin e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Për arsyet e lartcekura, aktgjykimi i kundërshtuar është dashur të priset dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, për t'i mënjeluar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore të theksuara më lartë, e që janë të tilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktgjykimit të goditur. Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet t'i mënjanoj të metat e vërejtura sipas këtij aktgjykimi, dhe pas mënjanimit të tyre, të bie aktgjykim të drejt dhe të ligjshëm në kuptim të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë, në ri procedurë, duhet të shqyrtoj pretendime paditësit lidhur me kompetencën e vendimmarrjen e kryetarit te komunës-paditurës, ne dyshkallëshmërisë te procedurës administrative. Gjykata e shkallës së parë, duhet ti shqyrtojë të gjitha vërejtjet e dhëna nga kolegji i kësaj gjykate, ti eliminoj të gjitha shkeljet e theksuara më lartë, të vendos në kuptim të nenit 160 të LPK-së, ashtu që dispozitivi dhe arsyetimi i vendimit të jetë i çartë dhe i kuptueshëm, të vendos për të gjitha kërkesat e palëve në procedurë, ti vlerësoj të gjitha provat veç e veç dhe të gjitha së bashku, dhe në fund të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, si dhe nenit 195 par.1 pika c), të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II.nr.1073/24 datë 25.09.2024

Kryetar i Kolegjit, gjyqtari,  
Ramush Bardiqi d.v.